



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I DËGJIMIT PUBLIK NGA KOMISIONI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR EKONOMI, INDUSTRI, NDËRMARRËSI DHE TREGTI,
MBAJTUR MË 5 NËNTOR 2024**

**SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA ZA
EKONOMIJU, INDUSTRIJU, PREDUZETNIŠTVO I TRGOVINU,
ODRŽANE 5. NOVEMBRA 2024. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2024**

Dëgjimin publik e drejtoi kryesuesi i Grupit punues, z. Driton Hyseni.

KRYESUESI: Atëherë mund të fillojmë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të nderuar pjesëmarrës në këtë dëgjim publik,

Fillimisht dua t'ju falënderoj secilin për gatishmërinë që sot jeni këtu me ne dhe së bashku të kemi një bashkëbisedim të hapur në lidhje me Ligjin për ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës.

1. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 04/L-111 dhe nr. 05/L-009

Ju e dini që konform Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Ndërmarrësi, Tregti dhe Industri, që ka fushëveprimtari pra edhe ndërmarrjet publike, në kuadër të fushëveprimtarisë së vet, pra bën edhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjeve, të cilat janë të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilat janë në fuqi në Kosovë, me qëllim që të marrim një pasqyrë të qartë, sa i takon asaj se sa ligji është i implementueshëm, sa ai ka gjetur zbatim të ndërmarrjet publike, sa u ka hyrë në punë dhe sa keni pasur mundësi që ju të afaroni suksesshëm me legjislacionin aktual.

Kështu që, ligjin i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008, e që mandej është amendamentuar dy herë, njëherë në vitin 2012 e mandej edhe në vitin 2015, ne e kemi trajtuar me grupin tonë të punës, i miratuar nga Komisioni, në përbërje të të cilit isha unë kryesues, Driton Hyseni, deputet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, po ashtu edhe deputetët e tjerë të Komisionit, siç është nënkryetarja Jeta Statovci, po ashtu nënkryetarja tjetër Fidan Jilta, dhe kolegët e tjerë të komisionit, me të cilët ne kemi ndërmarrë një seri aktivitete, me qëllim të monitorimit sa më të qartë të zbatueshmërisë së ligjit.

Në kuadër të aktiviteteve, sa për informacionin tuaj, po e shoh këtu që janë një pjesë e ndërmarrjeve që i kemi vizituar, pra kemi vizituar gjithsej trembëdhjetë ndërmarrje publike, përfshirë edhe një regjionale dhe një lokale, me qëllim që të kemi një pasqyrë të qartë si deputetë, si Komision, si Kuvend, të asaj se sa ligji ka qenë i efektshëm, cilat janë problematikat me të cilat po ballafaqohen ndërmarrjet publike sot në Kosovë në aspektin e implementimit të legjislacionit.

Por, gjithashtu, në të gjitha këto takime, qëllimi kryesor që e kemi pasur, edhe që mendoj se cila legjislatura duhet ta ketë si obligim, është që të shohim çfarë është e mundshme të ndryshohet në legjislacionin aktual, cila është perspektiva e ndërmarrjeve publike në këtë rast sa i takon ligjit dhe nevojës për ndryshim dhe këto mandej t'i kemi si pikësynim edhe të Komisionit, por edhe të

neve individualisht si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim që këtë fushë ta rregullojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, sa i takon aspektit legjislativ.

Ju e dini që në të gjitha diskutimet që kemi pasur me një pjesë që jeni këtu prezent. Po, për informacion edhe të atyre që nuk kanë qenë pjesë e vizitave që kemi bërë si komision gjatë monitorimit, ne jemi përpjekur maksimalisht që të trajtojmë disa prej aspekteve që ligj i parasheh duke nisur nga mnyra e bashkëpunimit me Njësinë për zhvillimin e politikave dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, e që drejtorin e saj sot e kemi këtu z. Prebreza, është me ne këtu dhe kemi mundësi që nga afër të bashkëbisedojmë.

Gjithashtu, kemi trajtuar edhe aspektin gjinor të përfshirjes në pozicionet ekzekutive brenda ndërmarrjeve publike. Por, gjithashtu kemi pasur fokus shumë të madh te kënaqshmëria që kanë konsumatorët të cilët ju i shërbeni si ndërmarrje publike. Mendoj që këtu qëndron edhe pika kryesore, qoftë e interesit tonë si deputetë dhe si Kuvend, por edhe të zyrtarëve të ndërmarrjeve publike, me qëllim që ne të kemi një kënaqshmëri sa më të madhe të atyre klientëve që ju u shërbeni, në këtë rast që janë qytetarët e Republikës së Kosovës, që në shumë fusha të ndryshme pra ju u shërbeni përmes ofrimit të shërbimeve që ju si ndërmarrje i ofroni.

Edhe një herë ju falënderoj të gjithëve për prezencën këtu. Para se ta merrni fjalën, do të ishte mirë për hir të procesverbalit që të prezantoheni dhe të tregoni se cilin institucion përfaqësoni, cilën ndërmarrje apo cilën organizatë e përfaqësoni këtu në dëgjimin publik, për hir të transkriptit dhe që ne mandej ta kemi lehtësisht të gjurmueshme e t'i kemi edhe këndvështrimet tuaja sa i takon zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Para se t'jua jap fjalën, po ia kaloj fjalën nënkryetares së Komisionit, që ka qenë edhe anëtare e grupit të punues për monitorimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, nënkryetares Jeta Statovci, edhe mandej mund të vazhdojmë edhe me kolegen Fidan Jilta, apo me diskutimet e panelistëve që janë këtu.

JETA STATOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ju përshëndes të gjithëve,

Ashtu siç u cek edhe paraprakisht, është konsideruar si një nga ligjet më të rëndësishëm, mirëpo që ka pasur nevojë të trajtohet edhe në kuadër të spektrit ligjor të saj.

Ne e kemi trajtuar materialin, i përcjellim vit pas viti raportet e ndërmarrjeve publike. Kemi pasur edhe një raund të vizitave për të parë gjendjen e secilës ndërmarrje, sepse jo të gjitha ndajnë të njëjtat sfida. Disa kanë pozicione të monopolit natyror, disa përballen me konkurrencë, mirëpo është vlerësuar të jetë i nevojshëm edhe ky dëgjim publik, ku ne e marrim një perspektivë ndërsektoriale, ku kemi akterë nga shoqëria civile, nga ndërmarrjet publike e të tjera.

Jemi këtu për të dëgjuar, duke pasur parasysh që brenda v. 2021-2023 kemi pasur një përmirësim dukshëm të gjendjes së ndërmarrjeve publike. Pra, konsiderohet një profit 143 milionë, kështu që kemi një situatë të ndryshme nga më herët.

Duke i marrë në konsideratë edhe sukseset e arritura, mirëpo edhe sfidat me të cilat përballen, do të shohim mundësinë që këto të reflektohen edhe në bazën ligjore.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë,

Të nderuar të pranishëm,

VALON PREBREZA: Përshëndetje për të gjithë!

Jam drejtori i Njësisë për politika në ndërmarrje publike pranë Ministrisë së Ekonomisë.

Ne menduam të rrimë në fund që të marrim pyetjet dhe opinionet që kanë të bëjnë në raport me Ministrinë e Ekonomisë dhe në fund t'i adresojmë ato.

KRYESUESI: Mund ta jepni këndvështrimin tuaj sa i takon implementimit të ligjit.

Për ju si njësi, a ka paraqitur ndonjë problem, a keni pasur ndonjë barrierë ligjore që ne mund ta konsiderojmë amendamentimin apo krijimin e themelimit e një legjislacioni komplet të ri?

Sa i takon implementimit të ligjit, do të ishte mirë ta jepni këndvështrimin tuaj.

ARBËRORE BERNICA-HASANI: Jam ushtruese e detyrës së udhëheqëses së Divizionit për politikën e ndërmarrjeve publike në Ministrinë e Ekonomisë.

Kam fatin që prej vitit 2014 e përcjell punën në Njësinë për monitorimin e ndërmarrjeve publike dhe ne stafi që jemi aty, jemi të mishëruar me zbatimin e këtij ligji direkt.

Njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike është një mekanizëm i cili është themeluar me Ligjin për ndërmarrjet publike, konkretisht me nenin 37. Është një mekanizëm që e ndihmon Qeverinë dhe Ministrinë në ushtrimin e të drejtës së aksionarit në ndërmarrjet publike qendrore.

Me Ligjin për ndërmarrjet publike, janë 18 ndërmarrje publike qendrore, mirëpo KEDS për momentin ka ndërruar statutin e saj, prandaj kanë mbetur në monitorim diku shtatëmbëdhjetë ndërmarrje.

Ligji për ndërmarrje publike është hartuar në vitin 2008 dhe është amendamentuar dy herë, por prapë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka nxjerrë në pah disa mangësi të cilat janë identifikuar si probleme dhe që ka sjellë deri te situata për ndryshimin a rishikimin e këtij ligji.

Hera e parë që kemi filluar ta rishikojmë, atëherë orientimi ka qenë në ndryshimin komplet të bazës ligjore. Për shkak të mangësive që janë paraqitur gjatë punës së monitorimit të bordit të drejtorëve, sepse kompetencat e Ministrisë, janë në ushtrimin e të drejtës së aksionarit në monitorimin e punës së bordeve në ndërmarrjet publike qendrore. Ndërsa në komisionin ministror për ndërmarrje publike, në këtë mekanizëm edhe ngrihen çështje të cilat debatohen lidhur me ndërmarrjet publike.

Faza e dytë në v. 2023 kemi filluar edhe me hartimin e koncept-dokumentin për hartimin e bazës së re ligjore për ndërmarrjet publike. Si problematika të cilat janë identifikuar, si pikë e parë ka qenë që Qeveria me gjithë obligimin ligjor, nuk e ka të rishikuar politikën e saj pronësore, e që përcaktohet arsyeshmëria e përgjithshme për pronësinë mbi NP-të dhe rolin e aksionarit në qeverisjen e tyre.

Ky dokument është hartuar në fillim edhe kur është zbatuar Ligji për ndërmarrjet publike në v. 2008 dhe prej atëherë nuk është rishikuar kjo politikë e pronësisë për ndërmarrjet publike.

Problematikë tjetër në pronësinë e NP-së, del në pah që NP-së zhvillojnë planet e tyre individuale të cilat hartohen nga menaxhmenti i ndërmarrjeve publike dhe ato miratohen pastaj në Bordin e drejtorëve të NP-ve.

Si sfidë në lidhje me këto plane është paraqitur edhe mosharmonizimi i këtyre planeve të bazuar në strategji sektoriale nga ana e secilës NP, që do të kishin për qëllim edhe matjen e performancës së ndërmarrjeve publike. Në rast kur objektivat janë kundërtënëse, atëherë politikat sektoriale edhe në aspektin komercial, ato duhet të harmonizohen me këto politika dhe kjo do të duhej të bëhej nga vetë ndërmarrjet publike.

Mungesë tjetër në lidhje me zbatimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, ka dalë në pah edhe monitorimi i performancës dhe llogaridhënies. Kjo është një sfidë për aksionarin, nga fakti se NP-të krijojnë dhe mbeten në pronësi të aksionarëve për të përmbushur objektivat komerciale e jokomerciale. Në shumë raste, objektivat dhe caqet bartin në vete edhe kosto financiare, që krijojnë vështirësi edhe në implementim dhe vendosje të prioriteteve.

Vendosja e një kornize adekuate institucionale për matjen dhe monitorimin e performancës kërkon edhe kapacitete dhe ekspertizë të nevojshme. Ekspertiza ka rëndësi të jetë edhe në aspektin sektorial në të cilin operojnë ndërmarrjet, kur dihet që kuadër të ndërmarrjeve publike operojnë ndërmarrje në sektorë të ndryshëm, siç kanë sektori i telekomunikacionit, ujërave, mbeturinave etj.

Problematikë tjetër është edhe mungesa e transparencës së mirëfilltë nga ana e bordit të drejtorëve në raport me aksionarin. Në ligjin aktual, është identifikuar si mungesë trajtimi i

mjaftueshëm për obligimet e NP-së për transparencë. Këto zbrazëti ligjore rritin tendencën që ndërmarrjet publike të mos përmbushin edhe obligimet sipas standardeve mbi të cilat operojnë.

Te raportimet vjetore të NP-ve ka mungesa, pasi nuk përfshihet aspekti mjedisor dhe social. Në anën tjetër, nuk është caktuar edhe një standard i përgjithshëm i raportimit për ndërmarrjet publike nga ana e aksionarit, si dhe nuk është përcaktuar afati për miratimin e raportit të performansës së NP-ve në Kuvend. Kjo paraqet edhe vonesë deri në rastin e aprovimit të këtij raporti.

Si mungesë në legjislacionin aktual është identifikuar edhe menaxhimi i riskut. Kjo nuk është e definuar qartë. Ky është një proces i zbatuar nga bordi i NP-ve për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet.

Po ashtu vlen të ceket se në legjislacionin aktual nuk parashihen edhe dispozita sanksionuese në rast të mospërmbushjes së objektivave të përcaktuara nga vetë ndërmarrja.

Të gjitha këto bëjnë që Ministria e Ekonomisë do të duhej të orientohet në hartimin e bazës së re ligjore, për eliminimin e të gjitha këtyre mangësive të paraqitura deri më tani që nga v. 2008.

KRYESUESI: Faleminderit!

Edhe ne e kemi hasur gjatë monitorimit që vlerësimi i Bordit bëhet nga vetë ana e Bordit, kështu që ndoshta me legjislacionin e ri duhet eliminuar këtë çështje. Kjo do të duhej të bëhej nga një autoritet jashtë bordit.

ARBËRORE BERNICA-HASANI: Me legjislacionin aktual, kërkohet që bordi për punën njëvjeçare të bëjë vetëvlerësimin për anëtarët e vet, por me nenin 28 të Ligjit për ndërmarrjet publike kërkohet që ky vlerësim të bëhet edhe nga vetë aksionari apo nga ndonjë konsulent tjetër. Këtë e lejon legjislacioni.

Realisht, këtë nuk kemi arritur ta bëjmë për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur herë pas herë dhe ka qenë edhe e pakuptimtë të vlerësohen bordet në një periudhë të shkurtër.

KRYESUESI: Faleminderit!

SHQIPE ARIFAJ: Përshëndetje!

Jam nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe përfaqësoj ndërmarrjet publike lokale.

Me ndryshimin e ligjit në v. 2012, komunave iu mundësua të themelojnë ndërmarrjet publike lokale. Kjo erdhi si rezultat se disa komuna ishin numër i madh për një ndërmarrje. Në disa raste, komunat kishin mungesë të një profili.

Gjatë këtyre tre-katër viteve ne kemi marrë vërejtje prej shumë komunave se është tejzgjatur procesi. Pra, ka tri katër vite që nuk është themeluar ndërmarrja publike lokale. E kemi Gjakovën e cila prej 2021 ka filluar proceduarat. Pastaj është Klina, Drenasi, Fushë Kosova, Prizreni e të tjera. Erdhi përfundimi i mandatit të kryetarëve, d.m.th. për katër vjet nuk ka arritur të themelohet një ndërmarrje publike lokale.

Kështu qytetarëve nuk u ofrohet shërbimi i caktuar. Ne kemi vërejtje dhe konsiderojmë se edhe pse ligji i ka rregulluar mirë, por kërkohet zbatim i ligjit. Komunitat edhe pse u është dhënë kjo e drejtë, shumë pak. deri tash vetëm Podujeva e ka themeluar, dhe një tjetër është në proces. Shumica janë në pritje me vite për të themeluar ndërmarrjet publike lokale.

Kërkojmë nga Ministria përkatëse t'i zhvillojë procedurat pak më shpejtë dhe t'u jep mundësi t'i themelojnë. Në këtë formë, po tejzgjatet tepër. Komunitat kanë thënë se kanë marrë një herë vërejtje se nuk i kanë pasur komplet dokumentet. Pastaj, gjatë kohës, i kanë plotësuar dhe i kanë dërguar herën e dytë, po përsëri thonë se janë duke pritur me vite dhe nuk po arrijnë të realizojnë këto qëllime.

KRYESUESI: Faleminderit znj. Arifaj! Z. Zeqiri, nga KOSTT.

EVETAR ZEQRIRI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Unë jam kryeshef ekzekutiv i KOSTT. Kjo është ndërmarrje publike me një rregullim të veçantë, për shkak se është e vetmja ndërmarrje publike e cila i raporton Kuvendit, për shkak që disa dispozita të Ligjit për ndërmarrjet publike nuk gjejnë zbatim në rastin e KOSTT. P.sh. të drejtat e ushtrimit të aksionarit. Ne raportojmë në Komisionin funksional të Ekonomisë. Po ashtu raportojmë edhe në dy komisione në Kuvend. Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, si dhe komisionet ad hoc me mandat të veçantë.

KOSTT është një prej ndërmarrjeve e cila funksionon në sektor tejet të rregulluar. Pra, bëhet fjalë për sektorin e energjisë, i cili është në mënyrë shumë rixhide i rregulluar. Jo vetëm nga aspekti teknik, po edhe nga aspekti financiar, mbi bazën e të cilit ne i zbatojmë tarifat, apo buxhetin tonë. Pra, të gjitha të hyrat tona lejohen prej Rregullatorit. Kjo paraqet një sfidë në vete për zbatimin dhe për maksimizimin e profitit, për të cilin u diskutua më herët për ndërmarrjet publike.

Çështje tjetër është edhe te zbatimi ose miksusi mes Ligjit të shoqërive tregtare dhe Ligjit për ndërmarrjet publike. Ne jemi shoqëri aksionare dhe ndërmarrje publike. Ajo që kërkohet prej neve, maksimizimi i vlerës për aksionarin, më shumë i takon Ligjit të shoqërive tregtare, sepse ky ligj në parim inkurajon ndërmarrjet të veprojnë si shoqëri tregtare. Ndërsa, në anën tjetër, Ligji për ndërmarrjet publike përcakton kufizimet të cilat e bëjnë këtë të vështirë.

Shpeshherë ekziston konfuzion apo dispozita të cilat nuk rregullohen prej ndërmarrjeve publike, ne duhet t'i referohemi Ligjit të shoqërive tregtare. Këtu nuk janë mirë të rregulluara.

Mendoj që ekziston një nevojë për harmonizim dhe të merren disa elemente të shoqërive tregtare, të cilat janë të mira në vetvete dhe të integrohen në Ligjin për ndërmarrjet publike.

Çështje tjetër është obligimet ndërkombëtare dhe çështjet e pavarësisë funksionale buxhetore dhe raportuese. Ne si ndërmarrje e infrastrukturës kritike, synojmë anëtarësimin në organizata ndërkombëtare të cilat kërkojnë specifika tejet të veçanta të cilat shpeshherë edhe mund të mos marrin parasysh rregullimin lokal, ose rregullimin shtetëror.

D.m. th. anëtarësimi ynë në ... paraqet sfida të veçanta të cilat ngjanjëherë Ligji për ndërmarrjet publike paraqet.

Një çështje tjetër sfiduese është se ne raportojmë në Kuvend, ndërsa politikat e energjisë zbatohen nga Ministria e Ekonomisë ose ministria e linjës.

Në kuptim të raportimit të aksionarit, ne raportojmë në Kuvend, ndërsa në kuptim të bashkëpunimit të ngushtë që ne e zbatojmë, e bëjmë me Ministrinë e Ekonomisë dhe me ministrinë e linjës. Ky bashkëpunim nuk është mjaftueshëm i qartë, për shkak të rregullimit specifik që ne e kemi në raportim.

Procesi i shthurjes dhe zbatimi i rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare siç është Sekretariati i Energjisë, po ashtu janë sfida në vetete që është mirë të adresohen ku duhet të sigurohet pavarësia e plotë funksionale dhe raportuese,

Menaxhimi i riskut u përmend më herët këtu. Ne jemi një ndër ndërmarrjet që jemi të certifikuar me ISO standarde dhe të cilët po e zbatojmë edhe standardin për menaxhim të riskut dhe sapo e kemi aprovuar edhe politikën në nivel të bordit për menaxhimin e integruar të rreziqeve.

Këto ishin disa prej çështjeve. Sa i përket kënaqshmërisë së konsumatorëve, ndonëse konsumatorët tanë fundorë janë qytetarët, konsumatorët e drejtpërdrejtë ose klientë janë ndërmarrjet e tjera të energjisë, të cilat po ashtu janë ndërmarrje tejet të rregulluar, siç është Distribucioni, furnizuesit dhe ndërmarrjet e tjera të energjisë, përfshirë edhe ndërmarrjet që janë këtu si Ibër-Lepenci e ndërmarrje të tjera që mund të themelohen.

Raportimi në Kuvend dhe në komisione ad hoc ndonjëherë kërkon angazhim të madh. Ne raportojmë në tri komisione. Këtu, sidomos te fushëveprimi i komisioneve të caktuara, mendoj që ka elemente të sqarimit, po këto ishin disa prej çështjeve kryesore që desha t'i ngre.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zeqiri! Po, patjetër, veç urdhëroni!

FLORENT TAHIRAJ: Përshëndetje për të gjithë! Jam Florent Tahiraj, sekretar i ndërmarrjes Posta e Kosovës. Përgjithësisht u thanë, si të them, të metat e përgjithshme të ligjit, por ndoshta pa dashur të përsëritem prapë, do t'i theksoj edhe disa çështje.

Ligji për ndërmarrjet publike si frymë e tij është rregulli i ndërmarrjeve publike. U përmend edhe çështja e pronave saqë nuk është e rregulluar përkundër që politika e pronësisë duhet të nxirret sa i përket këtij ligji edhe sesi do të menaxhohet çështja pronësisë. Ligji për ndërmarrjet publike nuk e ka të rregulluar këtë dhe sidomos në praktikë po qet shumë telashe se si të menaxhohet çështja e pronësisë, shtuar kësaj që pothuajse në çdo raport të auditimit të jashtëm ndërmarrjet publike e kanë si të gjetur këtë çështjen e pronësisë.

Përveç tjerash u përmend shumë edhe po besoj që komentet i kemi dërguar në takimin që e kemi pasur. I kemi dërguar diku janë rreth 20 pika që i kemi dërguar lidhur me plotësim-ndryshimin e këtij ligji, të cilat ne mendojmë që duhet të ndryshohet, mirëpo nuk po ndalem shumë përveç në 2-3 çështje kryesore.

Po besoj që përveç postës, këtu u tha që ka edhe ndërmarrje të tjera që qeverisen apo rregullohen prej ligjeve të veçanta, kështu që do të ishte mirë që edhe ligjet e veçanta të harmonizohen me Ligjin për ndërmarrje publike, i cili po ashtu duhet të harmonizohet me çështjet praktike në terren.

Nëse veç themi që Ligji për ndërmarrjet publike, në këtë rast po e lidh me Postën e Kosovës si ndërmarrje publike, atëherë duhet t'i japë edhe disa të drejta fundamentale të cilat kushtimisht po themi që pse ekziston posta.

Posta qeveriset përveç Ligjit për ndërmarrjet publike, e ka edhe Ligjin për shërbimet postare, gjë që konsideroj që duhet të jetë një harmonizim mes këtyre ligjeve dhe t'i jepen disa të drejta Postës së Kosovës, në kuptim si entitet juridik publik. Përveç kësaj, u tha edhe këtu që Ligji për shoqëri tregtare, Ligji për ndërmarrje publike e përcakton qartë që të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me Ligjin për ndërmarrjet publike, duhet t'i referohemi Ligjit për shoqëri tregtare.

Edhe shpeshherë me të drejtë krijohet njëfarëlloj konfuzioni se cili të merret parasysh, ndonëse aty-këtu disa dispozita mund të jenë edhe në kolizion njëra me tjetrën.

Prandaj, specifikimi sa më shumë i Ligjit për ndërmarrjet publike në raport me qeverisjen e ndërmarrjeve publike do të ishte i mirëseardhur. Përveç kësaj, në disa ndërmarrje kemi edhe konkurrencë në treg. U përmend Ligji i prokurimit publik. Tani kanë ndryshuar edhe udhëzimi

administrativ te çështjet e punësimit, gjë që i ka lehtësuar mënyrën e punësimit për ndërmarrjet publike që e ka rregulluar me akte të brendshme.

Ligji për prokurimin publik konsideroj që duhet të ndryshohet apo dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike duhet të jenë të veçanta sa u përket ndërmarrjeve publike në raport me konkurrencën.

Kuptohet, gjithmonë duke mos iu ikur parimeve bazë të prokurimit. Mirëpo, në qoftë se një ndërmarrje publike për një procedurë të prokurimit e merr një vjet për ta realizuar, konkurrenca në treg, siç e ka posta, mund ta realizojë për dy ditë këtë çështje. Dhe pastaj po mbetemi gjithmonë pas.

Përveç kësaj nuk do të lëshohem më shumë në çështje teknike, duke iu referuar pastaj edhe kompetencave të bordit në raport me ndarjen me kryeshefin ekzekutiv, ndonëse këto mund të jenë teknike. Mirëpo, kryesisht janë këto çështje të cilat duhet të kenë parasysh në veprimet ditore të ndërmarrjes, pastaj edhe proceset e të gjitha këto të tjerat. Faleminderit! Kaq kisha. Përndryshe, këto i kemi dërguar edhe me e-mail te komisioni. Po besoj që nuk ka nevojë të lëshohem në detaje teknike të ligjit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Tahiraj!

Me kënaqësi i kemi pranuar të gjitha ato komente tuaja, por në ndërkohë nëse veç keni edhe komente shtesë, lirisht mund t'i dërgoni si shtesë në adresën e komisionit. Ne me kënaqësi do t'i trajtojmë të gjitha.

Për informacionin tuaj, meqë diskutove edhe këtë Ligjin për shërbimet postare, ne me ARKEP në javën që shkoi kemi pasur diskutim si komision edhe na gëzon fakti që ARKEP ka marrë një vendim që është shumë i përafërt për të mbuluar të gjitha kostot sa i takon shërbimit universal që ka Posta e Kosovës, që e mbulon në Kosovë.

Mendoj që tash do të jeni në një situatë më të mirë sa i takon operimit dhe afarizmit në tërësi, duke e marrë si të nevojshme gjithashtu t'i inkorporojmë edhe këto vërejte që ju i keni dhënë në ligjin që mund ta kemi për ndërmarrjet publike, me qëllim që legjislacioni të mos jetë ajo pika ku ju ndesheni me barriera për të bërë një afarizëm të suksesshëm që mandej përkthehet në shërbim më të mirë për qytetarët e vendit.

Do të vazhdojmë me panelistët e tjerë këtu. Urdhëroni!

FARUK MUJKA: Faleminderit, kryesues i nderuar! Zotëri Heyseni, zonja Statovci, zotëri Lekaj dhe kolegë të nderuar! Jam Faruk Mujka kryeshef i Ndërmarrjes së Ibër Lepencit.

Tash, unë si inxhinier edhe si kryeshef ndoshta nuk mundem saktë t'i përcaktoj përparësitë dhe mangësitë e ligjit, por mund të them çka ndihmojnë ato në aspektin menaxherial dhe cilat ndoshta janë pengesat të mos them dobësitë, të cilat ne hasim në to gjatë kësaj kohe.

Ne si dhe shumica e ndërmarrjeve të tjera publike, ndoshta nuk e kemi problemin e postës dhe të konkurrencës, mirëpo gjithsesi i kemi sfidat tona në arritjen e performancës dhe gjithsesi këtë duke u bazuar në nenet dhe që derivojnë nga Ligji mbi ndërmarrjet publike, e rrjedhimisht edhe nga Kodi i Etikës.

Gjithsesi, unë do të vazhdoj ndoshta aty ku mbeti kolegu, ku tha nuk po dua të hyjë në detaje teknike, ...te ndarja e roleve ndërmjet bordit dhe ekzekutivit, ku të jetë një ndarje më e qartë e detyrave, bordit dhe ekzekutivit, sepse në emër edhe të tjerëve në ekzekutiv që janë këtu, atëherë mund të vijmë në përfundim se nganjëherë e kemi një, le të themi, mosmarrëveshje apo një miksim i detyrave të bordit edhe të kryeshefit.

Nganjëherë po kemi dëshirë të ulemi në të dyja karriget, herë në karrige të drejtorit të bordit, herë në karrige të kryeshefit. Le të ketë një ndarje më të qartë. Edhe e dyta, unë mendoj që Qeveria është aksionar qind për qind i ndërmarrjeve. Në qoftë se është Qeveria qind për qind aksionar i ndërmarrjeve, unë nuk e kuptoj atëherë pse duhet të ketë 6-7 anëtarë të bordit përfaqësues të aksionarit në ndërmarrje.

Unë e kuptoj kur ka shoqëria të mëdha, ku interesat e ndryshme me aksione të ndryshme. Por, në qoftë se është ndërmarrja qind për qind aksionare, atëherë nuk e kuptoj numrin kaq të madh.

Dhe e dyta, secila ndërmarrje publike i ka specifikat e veta. Ne si Ibër Lepenc kemi më shumë nevojë që të kemi ndërlidhje me disa ministri të caktuara, në këtë rast me Ministrinë e Ekonomisë, ku jemi edhe vartës të tyre. Por, në anën tjetër ne kemi nevojë t'i kemi kontaktet të përhershme me Ministrinë e Bujqësisë për shkak të ujitjes. Kemi nevojë të kemi kontakte të përhershme me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për shkak të resurseve të ujit.

Dhe, për shkak të planifikimit, ku preken rrugët e preket infrastruktura rrugore. Në njëfarë mënyre, ne do të kishim pasur nevojë që në bord të kemi persona, të cilët na e bëjnë njëfarë ure lidhëse me ministrinë përkatëse dhe të mos kemi nevojë për rrugë të stërzgjatura me shkresa, e-mail nëpërmjet ministrisë e të tjerë, po të kemi përfaqësuesin e tyre në bord dhe nëpërmjet tyre t'i zgjidhim çështjet që ndoshta janë më akute për neve.

Në anën tjetër, ligji si i tillë neve na ka ndihmuar Ibër Lepencit që të shtrihemi edhe në pjesën veriore. Ju e dini që një pjesë e madhe e infrastrukturës së Ibër Lepencit shtrihet në pjesën veriore. Pra, vet Liqeni i Ujmanit dhe centrali i Ujmanit është në Komunën e Zupin Potokut, ku

për neve është burim kryesor i të hyrave dhe normal ka qenë sfidë integrimi i pjesë apo infrastrukturës tonë në veri në ndërmarrje.

Dhe, duke e ditur se secila ndërmarrje e jonë gati ka pasur atje ato strukturat e tyre paralele, të themi ndërmarrjet si motra. Ligji si i tillë neve na e ka mundësuar thjesht edhe që ta bëjmë integrimin edhe të vet ndërmarrjes, po edhe të punëtorëve që kanë qenë në këto ndërmarrjet paralele. Thjesht, nuk kemi pasur asnjë telashe.

Mua më vjen mirë që në këtë realitetin e ri të krijuar e kanë kuptuar dhe punëtorët e ndërmarrjeve. Së paku ne edhe KOSTT-i me të cilin kemi pasur një bashkëpunim më të afërt e dimë që nuk e kemi pasur një telashe të tillë, e falë funksionimit të mirë të ligjit i kemi inkorporuar brenda ndërmarrjes edhe ndërmarrjet që kanë qenë paralele.

Ne, u përmend infrastruktura kritike. Kemi kërkuar edhe në takim me juve. Kemi pasur fatin t'ju presim në ndërmarrjen tonë. Edhe atje e kemi shprehur kërkesën që infrastruktura e Ibër Lepencit të trajtohet si infrastrukturë kritike, sepse mendoj se edhe është e nevojshme edhe duhet.

Vet fakti që Liqeni i Ujarnit e ka digën 108 metra. I ka 350 milionë metër kub ujë. Furnizon me ujë të pijes rreth 600-700 mijë qytetarë. 160 km kanale të hapura dhe të mbyllura. Unë mendoj që duhet të ketë një vëmendje më të madhe të institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës.

Dhe, një ndër shqetësimet tona, është vlerësimi i aseteve të ndërmarrjeve publike, gjë që po është problem për të gjitha ndërmarrjet publike, sepse në fund të vitit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, së paku të gjithë e kemi këtë vërejtjen e vlerësimit të aseteve të ndërmarrjeve.

Thjesht, a nëpërmjet Ligjit a nëpërmjet amendamenteve të na bëhet një qare që të gjitha ndërmarrjet të mund ta kryejmë këtë obligim ligjor që e kemi edhe ndaj Zyrës Kombëtare, po edhe ndaj institucioneve të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mujka!

Edhe për neve si anëtarë të këtij grupi pune të komisionit ka qenë kënaqësi t'ju vizitojmë juve edhe të gjitha ndërmarrje që kemi pasur mundësi brenda agjendës sonë t'i vizitojmë.

Sigurisht, që edhe ato që s'i kemi vizituar në këtë monitorim të ligjit, unë besoj që do të kemi rastin në monitorime të tjera t'i vizitojmë dhe nga afër t'i marrim ato këndvështrimet sa i takon performancës së operimit, po edhe aspekteve ligjore.

Por, gjithashtu, më lejoni që edhe unë të ndaj kënaqësinë si kryesues i këtij grupi edhe të anëtarëve të grupit që lajmet pozitive që i kemi marrë sa i takon performancës së Ibër Lepencit e të cilat derivojnë shumë nga shtrirja e funksionimit të rendit dhe ligjit në pjesën veriore të vendit,

kanë qenë jashtëzakonisht inkurajuese për vet ndërmarrjen, për punëtorët që janë aty, por edhe shërbimet që ju i ofroni qoftë në furnizimin e termocentraleve me ujë, qoftë qytetarëve me ujë të pijshëm apo të ujitjes së tokave që ju bëni.

Kështu që, uroj të vazhdoni me këtë ritëm të ngritjes së performancës edhe ne do të mbesim gjithmonë afër ndërmarrjeve si deputetë me qëllim që të kemi mundësi të arrijmë në nivele të tilla të kënaqshme për nivelin e shërbimeve që meritojnë qytetarët e vendit.

Do të vazhdonim me diskutuesit e tjerë. Me shumë kënaqësi ju dëgjojmë, kështu që të mos hezitoni. Urdhëroni, zonjë!

ILIRIANA HYSA: Përshëndetje për të gjithë! Unë jam Iliriana Hysa, zyrtare ligjore në Autoritetin e Konkurrencës. Pasi kam analizuar dhe shqyrtuar Ligjin për ndërmarrjet publike, vlerësoj se çdo ndërmarrje e cila kryen veprimtari ekonomike, pavarësisht formën juridike, mënyrën apo formën e organizimit, mënyrën e financimit, strukturën pronësore, është e obliguar që t'i respektoj rregullat e konkurrencës. Dhe, të veprojë konform Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Në funksion të kësaj, unë propozoj që të futet një nen që siguron, se ndërmarrjet publike nuk e përdorin pozicionin e tyre të veçantë ose të privilegjuar për të shtypur konkurrencën në treg. Pra, ideja është që të ketë një nen i cili referohet mbrojtjes së konkurrencës.

Sepse ndërmarrjet publike natyrisht janë të detyruara që të veprojnë konform parimeve të konkurrencës së lirë dhe të ndershme. Dhe, se duhet të sigurohemi që ndërmarrjet publike nuk e shfrytëzojnë pozicionin e tyre dominues në treg për të shtrembëruar këtë konkurrencë apo për të krijuar eventualisht barriera për hyrjen e ndërmarrjeve private në treg. Dhe, [do praktikë e ndërmarrjeve publike që konsiderohet si abuzim me pozicionin e tyre dominues, qoftë ajo diskriminimin e çmimeve, kufizimin e prodhimit apo aplikimin e kushteve të padrejta tregtare, natyrisht që të jetë e përfshirë në këtë nen dhe të hetohet sipas ligjeve respektive, në këtë rast, Ligji për mbrojtjen e konkurrencës.

Pra, ideja është që ndonjëherë mund të krijohet në opinion publik një perceptim që ndërmarrjet publike duke qenë që mund të kenë një status më të privilegjuar, por që me këtë nen, le të jetë i përfshirë edhe që të sigurohet një konkurrencë e drejt dhe fer.

Ky është mendimi im pasi kam analizuar këtë ligj. Kjo ideja, pra që të ketë një nen të veçantë në këtë ligj për mbrojtje të konkurrencës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Hysa! Sigurisht, koment me rëndësi. Unë mendoj që secila nga ndërmarrjet këtu nuk e ka vullnetin që të operojë jashtë normave të konkurrencës së

shëndoshë, mirëpo janë disa aspekte ligjore që i kemi hasur në disa prej ndërmarrjeve e që janë, le të themi, përmbajtje të ligjeve të tjera, jo të Ligjit për ndërmarrjet publike, të cilat në njëfarë forme, jo që i favorizojnë, po veç i penalizojnë ndërmarrjet publike nga operimi konform konkurrencës së shëndoshë.

Unë mendoj që kjo do të jetë një pjesë jashtëzakonisht me interes që të adresohet në momentin që do kemi një përpilim të legjislacionit të ri për ndërmarrjet publike në vend. Po, zoti Tahiraj.

FLORENT TAHIRAJ: Pikërisht kjo është edhe arsyeja që e thamë që të harmonizohet Ligji për ndërmarrjet publike me ligjet e tjera të veçanta. Nuk është çështja që ndërmarrjet publike e shtrembërojnë konkurrencën. Pikërisht ato janë të dëmtuara nga konkurrenca që e kanë.

Edhe autoriteti edhe të gjitha këto, ndërmarrjet publike nuk është që e mbrojnë konkurrencën. Ndërmarrjet publike, përkundrazi funksionojnë mbi bazën e të gjitha ligjeve që ato i aplikojnë. Mirëpo, këto e qesin në pozitë të disfavorshme në raport me konkurrencën që është në treg. Kjo është.

Edhe përkundër kësaj që ndërmarrjet publike si ndërmarrje publike janë të obliguara t'i ofrojnë disa shërbime për qytetarë. Po e lidh me postën. E përmendet shërbimin universal postar. Posta e Kosovës është e detyruar të ofrojë shërbimin universal postar, të dërgojë postën qoftë edhe qytetarit në fund atje, me kosto shtesë.

Për këtë nuk është çështje konkurrence, është çështje e obligimit se është element shtetësie në këtë çështje. faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Prej kompanive regjionale të ujësjellësve ende s'kam ndonjë...Urdhëroni!

FADIL BERISHA: Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë! Unë kam pasur rastin dhe privilegjin t'i bisedojmë këto edhe më herët, po vetëm desha të shtoj edhe t'i jap edhe disa propozime konkrete.

Unë mendoj si sfidë apo problematikë e zbatimit të këtij ligji ka qenë thjesht edhe mandati 3-vjeçar i zyrtarëve të lartë. Gjithmonë kur e them këtë, mendoj në rritjen e konkurrencës. Më falni, Fadil Berisha është ushtrues i detyrës të kryeshefit ekezekutiv në Hidroregjionin Jugor në Prizren. Ju kërkoj falje!

Në rritjen e konkurrencës dhe profesionalizimit. Besoj që ata që i kanë përcjellë konkurset e ndërmarrjeve publike e kanë vërejtur që jo rrallë shohin kompani të ujësjellësve që po kanë

nevojë t'i përsërisin, jo vetëm një herë, pozitat për zyrtarë të lartë apo edhe për kryshefë ekzekutivë.

Unë mendoj që ky është edhe një problem edhe i ligjit që mendoj që në të ardhmen duhet të mendohet në këtë drejtim, që në rend të parë që mandati 3-vjeçar të zgjatet minimumi, 5-vjeçar, por në asnjë mënyrë nuk mendoj që t'i iket zbatimit të nenit 18, pikës 18.3, e kam fjalën te vlerësimi i performansës dhe llogaridhënies dhe masat ndëshkuese nga bordi.

Gjithmonë e kam, po e potencoj edhe njëherë, në rritjen e konkurrencës dhe profesionalizmit të këtyre zyrtarëve pasi që unë mendoj me të vërtet kemi probleme në këtë drejtim. Po e lidh këtë propozim edhe me një çështje tjetër. Mendoj që, ose nuk është sqaruar mirë ose është keqinterpretuar nga bordi përfshirja e kryeshefëve ekzekutivë në përzgjedhjen e zyrtarëve të lartë.

Nuk e di kompanitë e tjera, por unë mendoj kam pak përvojë edhe unë në ndërmarrjet publike. Mendoj që kjo duhet, sipas mendimit tim nuk duhet të jetë kompetencë direkt e bordit, gjithmonë po e lë anash auditorin e brendshëm. Atë nuk duhet, edhe unë mendoj që duhet të jetë komplet jashtë kompetencave të kryeshefit ekzekutiv. Por, në asnjë mënyrë që kryeshefi ekzekutiv të mos ketë përfshirje në përzgjedhjen e zyrtarëve të lartë ose të menaxhmentit të lartë, sepse unë mendoj që këto janë ato shtyllat kryesore të bashkëpunimit, po edhe të arritjes së performansës në nivel të kompanisë. Ju kërkoi falje për kohën! Mendoj që isha i qartë në propozimin tim.

KRYESUESI: Ne vetëm ju falënderojmë, zoti Berisha edhe për ardhjen edhe për komentet edhe për bashkëbisedimin më herët që e kemi pasur. Jemi këtu për të synuar një legjislacion sa më të mirë, kështu që pa asnjë hezitim. Jeni të mirëseardhur të gjithë.

AJSUN ABDULLAHU-SADIKU: Përshëndetje! Jam Ajsun Abdullahu-Sadiku, sekretare nga KRU Hidromorava në Gjilan. Fillimisht, ju përshëndes të gjithë panelistët dhe faleminderit që na e keni dhënë mundësinë të marrim pjesë në këtë dëgjim publik, lidhur me implementimin e Ligjit për ndërmarrje publike.

Unë jam ende e re në mandat dhe ju më herët thatë se diskutojmë edhe për sfidat të cilat ne kemi hasur gjatë implementimit të ligjit dhe kisha dashur t'i përmend dy pao tri sfida për këtë dhjetëmujor të mandatit tim aty si sekretare.

Njëra ndër to ka qenë pikërisht siç tha edhe parafolësi, kisha dashur të ndërlidhem të neni 21 i Ligjit për ndërmarrje publike, ku paragrafi 4 përcakton kriteret të cilat duhet t'i përmbushin zyrtarët e lartë që të jenë të përzgjedhur për atë pozitë.

Ndër to, ne e kemi një problem në KRU Hidromorava në Gjilan me auditorin e brendshëm. Domethënë, konkursi dështon që tri herë dhe konsiderojmë që njëra ndër arsytet është edhe mosharmonizimi i Ligjit për ndërmarrjet publike me Ligjin për kontrollin e brendshëm të financave të publike, ku e dimë krejt që Ligji për ndërmarrjet publike thotë se duhet të jetë një ekspert në kontabilitet, ndërsa Ligji për kontrollin e financave publike e përcakton se duhet të patjetër i certifikuar si auditor i brendshëm.

Dhe, në këtë rast, ne e dimë që duhet të mbizotërojë Ligji për ndërmarrje publike, mirëpo në konkurse duhet t'i qesim të dyja kriteret, ku kemi mungesë të konkurrencës dhe si rezultat konkursi dështon që tri herë dhe nuk kemi kandidat as potencial, e lerë më të suksesshëm për këtë pozitë.

Kjo është njëra ndër problematikat të kompanisë sonë. E dyta, kisha dashur prapë të lidhem te neni 21 për shkarkimin e zyrtarëve të lartë. Jemi dakord ndoshta dhe me mandatin, mirëpo paragrafi se mund të shkarkohen edhe pa arsyetim, konsideroj që nuk është shumë i drejtë pasi që e krijon njëloj stresi dhe presioni gjatë gjithë kohës te zyrtarët e lartë për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, sepse konsideroj se duhet të jetë një vlerësim i performancës si kusht për ta bërë shkarkimin apo vazhdimin e mandatit të zyrtarëve të lartë.

Ky është mendimi im personal. Sigurisht, nuk do të thotë se është i drejtë apo jo.

Edhe një problematikë tjetër kisha dashur ta ndaj këtu. Është mungesa e këshillave juridike në vendimet e bordit. Ta them të drejtën kemi plot raste sidomos me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, ku së fundmi jemi ballafaquar shumë si kompani dhe ne e kemi të paqarta se kush është instancë e dytë e cila duhet t'i vlerësojë vendimet e bordit. A është administrative apo gjyqësore. Ne nuk kemi dispozitë konkrete ligjore në Ligjin për ndërmarrje publike se kush është autoriteti i cili duhet në njëfarë mënyrë t'i rishikojë vendimet e bordit të drejtorëve. Faleminderit! Kjo ishte e gjitha.

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuar Ajsun!

I vlerësojmë shumë komentet tuaja. Po i jam përparësi. Nga GLPS-së.

EMA PULA: Përshëndetje për gjithë! Jam Ema Pula nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Pasi që veç vazhduam që të flasim për përzgjedhjen e zyrtarëve, ne do të kishim ngritur çështjen e përzgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv në ndërmarrje publike.

Kjo ka të bëjë ndoshta edhe me amullinë që e shkakton vet ligji sa u përket kriterëve, pikës K në fakt, që një kryshef ekzekutiv apo një zyrtar i lartë nuk duhet të jetë në 36 muajt e fundit i emëruar politik apo në një pozitë vendimmarrëse në parti politike.

Megjithatë, këtu kemi kundërthënie mes dy neve. E kemi nenin 17 që thotë që përveç kryeshefit ekzekutiv, pra e përjashton ndërsa neni 21 e përfshinë. Në vitin 2019, nëse s'gabo, e kemi pasur një opinion ligjor lidhur me këtë çështje, ku është rikonfirmuar që ky neni, kjo pika K vlen edhe për kryeshefin ekzekutiv. Pra, i njëjti nuk duhet të jetë në 36 muajt e fundit i emëruar politik apo në pozita vendimmarrëse në parti politike.

Por, që kemi parë këto vitet e fundit një praktikë të ndryshme nga ndërmarrja publike në ndërmarrje publike. E kemi rastin e Infrakos-it, kryeshefti ekzekutiv, ku kjo pikë ka qenë e detyrueshme edhe e shkruar në konkurs. Megjithatë, kemi ndërmarrje si Ibër Lepenci dhe Termokos-i nuk i janë përmbajtur kësaj pike.

Ndoshta edhe një sqarim nga ministria, sponzuriuse e këtij ligji, po në të njëjtën kohë le të jetë edhe reflektim që njëjta të adresohet në projektligjin e ardhshëm.

KRYESUESI: Faleminderit!

VULLNET BUGAQKU: Së pari përshëndetje për të gjithë! Unë jam Vullneti nga organizata KDI. Ne si KDI këtë vit kemi publikuar një studim të vlerësimit të integritetit të institucioneve në Kosovë, ku në mesin e këtij vlerësimi janë edhe ndërmarrjet publike. Megjithatë, me keqardhje e them që bazuar në disa indikator që janë krijuar nga një organizatë ndërkombëtare siç është Transparency International, ndërmarrjet publike sivjet kanë dalë me një performansë më të keqe të vlerësimit.

Si rrjedhojë e kësaj, ne kemi paraqitur edhe disa rekomandime, ku në pranverë të këtij viti vetëm se e kemi publikuar raportin, dhe në kuadër të këtyre rekomandimeve burojnë edhe shumica e këtyre çështjeve që u përmendin edhe nga Ajsuni edhe nga Ema.

Do të thotë, Ligji për ndërmarrjet publike është nevojë edhe është domosdoshmëri që të fillojë ndryshimi dhe plotësimi i tij. Sidomos tek aspektet mbi përcaktimin e qartë të kriterëve për shkarkimin e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.

Në Kosovë, duhet pranuar hapur, është fenomen. Sa herë që ndërrohet një qeveri shkarkohen anëtarët e bordeve. Me ndërrimin e qeverive ndërrohen edhe anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike.

Pra, nuk bëhet një vlerësim i performansës ose një vlerësim mbi punën dhe kapacitetet ata që kanë vepruar gjatë mandatit të tyre, por është bërë si normë e punës që secila qeveri që vjen në pushtet i ndërron ndërmarrjet publike, të paktën këto qendrore.

Mbi të gjitha, raporti ka gjetur se njësia e politikave dhe e monitorimit të ndërmarrjeve publike nuk ka buxhet të mjaftueshëm dhe nuk ka kapacitete. Ne e kemi e vlerësuar të mjaftueshme për ta ushtruar rolin e saj në mënyrë mjaft efektive dhe për këtë kemi bërë thirrje që Qeveri të ofrojë buxhet shtesë dhe të ofrojë edhe kapacitete dhe resurse shtesë që kjo njësi ta luaj rolin e saj në mënyrë më efektive.

Çështje tjetër që ligji nuk parasheh, unë besoj është që çështja e përfaqësimit gjinor nëpër ndërmarrjet publike. Pra, e kemi një ligj që është Ligji për barazi gjinore që kërkon pak a shumë ai vlen edhe për ndërmarrjet publike, sepse janë institucione që paguhen nga buxheti i shtetit.

Prandaj, edhe duhet pasur parasysh që emërimi i anëtarëve të bordeve në ndërmarrje publike, por edhe i drejtorëve edhe i zyrtarëve të lartë të tjerë të marrë pak për bazë edhe çështjen e përfaqësimit gjinor në këtë ndërmarrje.

Ka edhe disa kritere të tjera ose edhe disa rekomandime të tjera, të cilat unë nuk po dua tash për tash ta zgjas. Unë do t'jua dërgoj raportin në e-mail juve, dhe besoj që nëse do të kemi mundësi tjetër do të diskutojmë edhe në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Ema dhe Vullnet për këto komentet e fundit. Megjithatë, mund ta japim si informacion që në mënyrë shumë përmbajtjesore është ngritur ky numri i përfaqësimit të aspektit gjinor sidomos në pozitat ekzekutive nëpër ndërmarrje.

Diku në nivelin 45 % e kemi aktualisht. Besoj që mund të shkojmë edhe te 50 %-shi, le të themi, ta marrë atë pozicionin meritore që mendojmë secili. Po.

Po, urdhëroni zonjë!

KIMETE FAZLIU: Përshëndetje të gjithë pjesëmarrësve, jam Kimete Fazliu, në cilësinë e anëtarit të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore “Train Kos” sh.a.

Sa i përket ligjit domethënë, nismat legislative janë shumë të arsyeshme sidomos tash në rishikimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, qysh prej vitit 2008 edhe ndryshimet që janë bërë edhe dy herë radhazi. Unë kisha propozuar që ne neni 21 dhe parafolësja më herët që e tha, neni 21 paragrafi 21.4. përmban dispozitat lidhur me kriteret e përzgjedhjes së zyrtarëve të lartë të kompanisë. Sa i përket kritereve është mirë që të jenë të ndara se në këtë dispozitë referohen edhe paragrafët e nenit 17.1 dhe 17.2. këto paragrafë rregullojnë kriteret e kualifikimit për anëtarët e bordit të drejtorëve. Kishte qenë mirë që ndarjet të specifikohen për pozitat e zyrtarëve të lartë se praktikisht shumë herë që i kam pa konkurset e ndërmarrjeve publike, interpretohen, keq interpretohen edhe interpretohen në mënyra të ndryshme domethënë nuk, është prej

vështirësisë e kam has domethënë edhe prej njerëzve që nuk mundën me i interpretua drejt kriteret, është mirë që të bëhen ndaras mos të ketë referenca nga nenet tjera.

Domethënë, veçmas për bord të drejtorëve, veçmas për zyrtarët e lartë. Kishte me qenë shumë më lehtë praktikisht me u zbatua më lehtë në praktikë.

Edhe sa i përket domethënë neni, çdo ligj kuptohet që i parasheh që aktet nënligjore duhet me u nxjerrë edhe për Ligjin për ndërmarrjet publike ka nevojë të nxirren disa akte nënligjore, sidomos me i paraparë këto procedurat e përzgjedhjes të zyrtarëve të lartë të kompanisë për me pas më lehtë në praktikë se edhe të japin instruksione më të drejta, është problem nganjëherë në praktikë me i paraparë derisa nuk e ki një bazë ligjore diçka me pas si orientim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe prej juve, zonja Fazliu për komentet. Ashtu siç e thashë edhe në fillim përveç komenteve që jepni këtu mundeni edhe me shkrim nëse mendoni që duhet me u formulua në mënyrë më të detajuar të gjitha propozimet edhe mandej mundeni të na i dërgoni qoftë deri në fund të javës apo mund të dakordohemi këtu ditën e hënë që vjen pra me datë 11 nëntor, ta kemi si datë kur i pranojmë apo datën e fundit kur i pranojmë të gjitha komentet prej anës tuaj edhe me shkrim edhe mandej t'i kemi në këndvështrim apo në analizë të grupit të punës.

Nëse nuk ka dikush tjetër me shtua diçka atëherë ia kishim kaluar fjalën Valonit, disa çështje që u ngritën unë mendoj që ka nevojë edhe për përgjigje nga ana e njësisë. Po, urdhëro Valon!

VALON PREBREZA: Faleminderit, zoti Hyseni! Po filloj prej kësaj së fundit te përfaqësimi gjinor. Ne jemi përkujdes me e zbatua ligjin edhe realisht në 90% të ndërmarrjeve publike në bordin e drejtorëve janë 50% të përfaqësuara kuota gjinore edhe aty ku nuk është, është vetëm për çështje që nuk ka pas aplikues të gjinisë femërore.

Sa i përket kësaj të ndërrimit të bordit të drejtorëve nuk qëndron, rasti i fundit ta zëmë po e shoh këtu e kemi që është prej Telekomit, Bordi i Drejtorëve të Telekomit ka qenë prej qeverisë së kaluar i cili e ka përfunduar mandatin deri në fund. Tash, te shkarkimi i zyrtarëve të lartë që është ajo për shkak të detyrave apo pa arsye që quhet prej shumicës së zyrtarëve të lartë unë mendoj që ajo duhet me mbet aty se unë mendoj që ajo pak a shumë i mban nën presion për me pas kujdes në punën e tyre. Mundet me qenë gabim, mirëpo të paktën kur e din që edhe mundesh me u shkarkua për shkak të krijimit të mosbesueshmërisë të anëtarëve të bordit apo të Komisionit të Auditimit niveli i përgjegjësisë është më i lartë. Kështu që se i kam shkruar kështu në temat, të cilat janë prekë po mundohem me u përgjigj.

Se ka filluar prej fillimit unë fillova prej fundit, te konkurrenca në treg besoj që Floreti nga Posta e qartësoi shumë qartë problemin që e kemi me Postën për konkurrencën domethënë në

ndërmarrjet publike nuk kanë monopol edhe që e pengojnë sektorin privat, përkundrazi sektori privat është pengesë për ndërmarrjet publike konkretisht të Ligji i prokurimit dhe të ligjet tjera që në njëfarë forme e penalizojnë ndërmarrjet publike në operim.

Te infrastruktura kritike që u cek nga KOSTT-i dhe “Ibër Lepenci” po ne kemi marrë veprime të caktuara për këtë pikë dhe janë takimet e vazhdueshme me Ministrinë e Mbrojtjes po besoj që veç jeni takuar edhe KOSTT-i, “Ibër Lepenci” dhe KEK-u edhe të gjitha ndërmarrjet tjera që janë të parapara në infrastrukturën kritike që të vazhdohet më tutje. Jemi duke e prit një plan të veprimit prej anës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe mandej aprovimin e tyre nëse ka nevojë për buxhet nga ndërmarrjet publike.

Tek, po kthehem tek asociacioni, të Shqipe Arifaj. E nderuar, po kemi kërkesa të vazhdueshme të komunave për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale, disave edhe ju kemi dhënë aprovim të tillë. Mirëpo, është një problematikë në veti, ta zëmë e përmende Gjakovën, Gjakova i ka tri ndërmarrje publike lokale. Nuk e di çka i duhet e katërta, por ta marrim shembull ka komuna që shumica e komunave mos të them 90% kërkesën e kanë pa studim të fizibilitetit, kurrfarë studimi të fizibilitetit nuk kanë bërë për një kërkesë të tillë.

Tjetra, nuk e përfshin në plan të buxhetit, as nuk e kanë buxhetuar, plus çka është edhe më interesantja është që e kemi pas një prezantim të organizuar prej GAP-it pikërisht për këtë temë e të cilët i ka ftuar të gjitha komunat që kanë aplikuar për leje, për krijimin e ndërmarrjes publike dhe aty është si e gjetur apo si opinion i fundit ka dalë që kjo kërkesë e tillë është vetëm për krijimin e vendeve të reja të punës në njëfarë forme veç për punësim të militantëve të tyre. Çka nënkupton kjo? Kjo nënkupton që ka ndërmarrje publike lokale që është krijuar në të kaluarën, që e përbën numrin më të madh të të punësuarve se sa vetë komunat.

Domethënë, rehati politike ashiqare. Plus më e keqja që është për arsyen e krijimit të kësaj ndërmarrje apo të llojit të tyre prapë vazhdojnë me dhënie të tenderëve të kompanive private edhe pse e kanë themeluar ndërmarrjen për mbulimin e veprimtarive, të pastrimit të rrugëve, pastrimit të varrezave, të parqeve të ndryshme, parkingje e tjera, prapë vazhdojnë të japin tenderë për kompani private.

Mandej janë edhe qesharake kërkesat, për shembull ka kërkesa për ndërtimin e banesave. Domethënë në njëfarë forme sikur me dashtë me rikthye veprimtarinë e Ramiz Sadikut, domethënë janë kërkesa absolute, mundem me ju tregua kurdo që keni vullnetin me ardh në Ministri ua tregojmë kërkesat, të cilat janë prej komunave. Nuk ka pengesa politike, ne kemi lëshuar për Komunën e Suharekës, e Pejës, e Podujevës e cila mandej ka ardhur me kërkesë për bashkimin e ndërmarrjeve të cilën jemi duke e trajtuar, tash po besoj në mbledhjen e Këshillit ndërministror do ta trajtojmë.

Mirëpo, edhe një gjë tjetër se nuk u përmend desha ta përmendi më herët, është Ligji për fondin sovran. Ligji për fondin sovran i nderuar Hyseni, ka një vit që është miratuar, mirëpo siç e dimë prej opozitës, konkretisht prej PDK-së ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese. Mandej, Gjykata Kushtetuese e ka pesëfishuar kohën e kthimit të përgjigjes duke u thirr me një nen që nuk është më në fuqi.

Do të thotë, edhe Ligji për fondin sovran e bllokton në njëfarë forme ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, sepse ne duam të dimë se çka po ndodh me Ligjin për fondin sovran. Ne e kemi koncept-dokumentin gati për Ligjin për ndërmarrjet publike edhe me kalimin, definimin se çka do të ndodh me Ligjin sovran po besoj që kemi me vazhduar me procedim. S'di a mbeta borxh diçka, nëse kam mbetur borxh po besoj...

KRYESUESI: Po?

EMA PULA: Për përzgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv, a vlen pika K edhe për kryeshefin ekzekutiv?

VALON PREBREZA: Për besë nuk është se na kanë kërkuar opinion ligjor për këtë punë, me sa e di unë ne s'kemi dhënë opinion ligjor.

EMA PULA: Edhe ne kemi kërkuar në janar të vitit 2023, por nuk kemi përgjigje.

VALON PREBREZA: Nuk jemi përgjigj, po kemi pa aty arsye po, tash nuk janë

Vlerësimi i asetëve të pronat që është përmend te ndërmarrjet publike u përmend. Do të thotë, nuk ka raport të auditorit që është përmend pronësia, por përmendet vlerësimi i asetëve të të gjitha ndërmarrjeve.

Ne ju kemi kërkuar ndërmarrjeve publike që me nda fond të veçantë, më pastaj me pa si qeveri angazhimin e një konsulence të jashtme për vlerësimin e këtyre asetëve që nuk është bë prej 2007, por prapë po dal këtu te Ligji sovran e determinon qartë se qysh kemi me vazhdua tutje.

KRYESUESI: Urdhëro, nga GAP-i, fjala.

BESART ZHUJA: Meqë u përmend edhe instituti jonë, unë jam Besarti prej Institutit GAP. I dëgjova shumë shqetësime të kolegëve këtu, në kuadër të një projekti i cili quhet ne e bëjmë monitorimin aktiv edhe pasiv kisha me thënë të shumicës së ndërmarrjeve publike në Kosovë i mora disa shënime këtu, po mundohem me shkua gradualisht me i përmend disa pika.

Një çështje shqetësuese që është, është për shembull çështja e pronësisë determinimit të një strategjie të qeverisë ndaj pronësisë së ndërmarrjeve publike. U përmend që shumica e ndërmarrjeve publike qendrore janë 100% qeveri aksionar, kështu që nevojitet një strategji më e detajuar sidomos në sektorin e ujërave për shembull ose energjisë ku duhet një fokus më i madh për shkak të projekteve voluminoze të mëdha që i kanë. Për shembull, e kemi rastin e “Ibër Lepencit” qysh e përmendi edhe zoti Mujka që 1/3 e popullatës furnizohet me ujë, jo vetëm me ujë po edhe energji elektrike një pjesë e asaj.

Nuk e di a është tryeza e duhur me të një provokim po po e lo si provokim këtë pikën që tek aspekti i ujërave çka ndodh nëse Serbia na nxjerrë një digë në Ujman edhe për 48 orë ne kemi problem edhe me u furnizua me energji elektrike. Ekziston përkundër marrëdhënieve ndërkombëtare, Ligjit të ujërave që nuk guxon një shtet me ia ndërtua një digë tjetrit po Etiopia është duke ia bërë Egjiptit, por Egjipti e ka njëfarë fuqie që i thotë “t’i nxjerrni aeroplanët edhe e kryjmë këtë punë”.

Pra, këtu duhet me të thirrje ndoshta qeveria me pas në konsideratë që duhet me mendua hala më strategjikisht për ujërat edhe për ndërtimin e bazenëve të rinj. Tek aspekti që çalon më shumë aspekti i ndërmarrjeve publike është aspekti i ndërmarrjeve lokale siç e përmendi edhe drejtori, një diçka që mungon ose që nuk ka një rregullim në proces ligjor është çështja e mbikëqyrjes së ndërmarrjeve lokale që janë 100% në pronësi të komunave ose ndërmarrjeve rajonale mbi të cilat komunat kanë aksione dhe emërojnë anëtarë të bordit.

Kjo lidhet edhe me përveç llogaridhënies lidhet edhe me aspektin gjinor ku kemi ndërmarrje publike rajonale të mbeturinave pa dashtë me përmend emër, por që kanë problem për shkak se krejt bordin e kanë burra. Edhe pastaj duke e pas krejt bordin burra dalin probleme të reja që nuk mundën me i përditësua të dhënat në ARBK e disa probleme tjera, përndryshe sa i përket aspektit gjinor ligji e potencon saktë që bordet duhet të jenë 50:50 por nuk precizon nëse menaxhmenti duhet me qenë i ndarë 50:50 kështu që e kemi vërejt një iniciativë edhe te ndërmarrjet publike që me e rregullua pak a shumë këtë aspekt në mirëbesim për shkak se nuk ka një detyrim ose obligim ligjor që i kërkon ndërmarrjeve publike një baraspeshë gjinore në struktura menaxheriale.

Kur përmendet çështja strategjike ose mendimi strategjik, orientimi i bordeve në punën e vetë shumica e ndërmarrjeve e kanë një mision që e trashëgojnë, do të thotë në momentin kur bordi zgjidhet e ka një mandat pak a shumë mirë të precizuar, një mision të ndërmarrjes edhe në kuadër të këtij misioni ekzistojnë edhe disa parametra tjerë mbi të cilat bëhet vlerësimi i performancës edhe të bordit edhe të menaxhmentit.

Për shembull, i kemi planet e biznesit për të cilat Instituti GAP ka bërë disa hulumtime rreth përmbushjes së planit të biznesit. Fatkeqësisht ka çalime të mëdha në përmbushje të planit të

biznesit, bordi duhet t'i ketë parasysh këto për shkak se shumica e ndërmarrjeve në plan të biznesit e futin edhe një pra i kategorizojnë edhe vështirësitë që i kanë aty, edhe kjo duhet me u pa në kuptimin se sa bordet janë duke pas një mendim strategjik ose vendime strategjike në adresim të atyre vështirësive. Tash Instituti GAP aktualisht është duke u marrë edhe me këtë pjesë, duke i analizuar edhe sa strategjike janë vendimet e bordit kundrejt problemeve dhe vështirësive, të cilat vetë bordi i aprovon.

Ka aspekte tjera, por që isha ndal me këtu veç desha me i theksua edhe këtë pjesën e ndërmarrjeve lokale meqë edhe u përmend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti !

Zoti deputeti Lekaj e ka fjalën, dhe jemi duke shkuar kah mbyllja kushdo që do mundet ... po.

HASAN KRASNIQI: E pashë që nga kolegët edhe nga njerëzit profesionalistë ... shumë probleme në lidhje me ligjin, një gjë që nuk u cek është rritja e aseteve me kapital vetanak te ndërmarrjet publike.

Është një gjë shumë esenciale që kisha pas dëshirë me ligj me u përcaktua. Edhe një herë rritja e kapitalit ose aseteve te ndërmarrjet publike me kapital vetanak. Ne si ndërmarrje shembull kemi nevojë për parking të 60 automjeteve që në kompaninë tonë janë në funksion dhe nuk kemi ku t'i parkojmë, çdoherë duhet me marrë me qira parking, është pamundësi e madhe për me gjetur hapësirë, ndërsa kemi një mundësi shumë të mirë që me i kapitalizua ose me ble një parking.

Po ashtu, kemi një mundësi shumë të mirë afër zyrave tona për të blerë një hapësirë për zyrat tona. Në mungesë të zyrave duhet me i fut nga 5-6 vetë me një zyre ose në mungesë të parkingut duhet me u reduktua shumë potenciali ose lëvizshmëria ose largësia e shërbimit teknik. Flas për kompaninë e ujërave se ka edhe kompani të funksionaliteteve të ndryshme.

Prandaj, rritja e kapitalit vetjak e aseteve me kapital të kompanisë ma merr mendja se duhet me u përcaktua dhe duhet me hy si çështje ligjore e cila vetëm ka për të rritur funksionalitetin dhe ka për të rritur madhësinë dhe asetet e kompanisë. Për momentin kjo punë është e pamundur.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi. Atëherë, zoti Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kolegu Driton.

Të nderuar të pranishëm,

Ajo që dëgjova me vëmendje, nuk pashë ndonjë propozim sa i përket neneve përkatëse për plotësim-ndryshim të Ligjit për ndërmarrjet publike. Kur e them këtë e kam parasysh që nëse nuk pajtohem me një nen atëherë është dashtë që me amendamentua ju dhe me pru propozimin e

saktë që të bëhet ndryshimi i atij neni që shkon me funksion të një menaxhimi më të mirë dhe një monitorimi të saktë, apo një implementimi të ligjit përkatës.

U përmendën shumë çështja e kolizionit mes ligjeve, për shembull u përmend Ligji për ndërmarrjet publike dhe u përmendën shoqëritë tregtare apo ndërmarrjet shoqërore. Dihet që nëse ligji bazë e përcakton atëherë merret parasysh ligji bazë dhe nëse ka interferim të ligjeve ta marrim nëse është shoqëri aksionare dhe duhet Ligji për tregti do të thotë atëherë merret për bazë ajo që ligji për shoqëritë tregtare. Apo nëse jemi në ndërmarrjet shoqërore, këtu e kemi paraparë që qeveria të ndërhyjë në disa ndërmarrje nëse e sheh të arsyeshme dhe që ta largojë apo ta veçojë nga ndërmarrja shoqërore që është okej, por unë nuk po pajtohem që ne t'i disiplinojmë bordet apo personalitetet, apo zyrtarët me ligj dhe që t'i qesim në ankth një zyrtarë të lartë, sepse dihet në krejt botën ne duhet me zhvillua veprime demokratike, por duke u bazuar në ligje demokratike dhe jo diktatoriale.

Kur e them këtë e kam parasysh nëse një zyrtarë i lartë e sheh aty një nen që thotë “mund të përjashtohet” pa performansë, pa një vlerësim çka i bie kjo? Besomëni i bie puro diktaturë që nuk guxojmë ne ku jetojmë në një shtet demokratik me ligje demokratike, sepse nuk disiplinohet dikush me dhunë. Po, nëse shkel ligjin janë organet kompetente dhe dihet shkalla edhe administrative dhe ligjore, dhe gjykatave dhe të gjitha. I përcakton ligji saktë, sa i përket opinionëve këtu u përmend nga disa zyrtarë.

Opinion i ligjor duhet me u bazua në ligj, nuk mund të jetë diçka jashtë neneve apo udhëzimeve administrative, dhe nëse ti jep një opinion ligjor që nuk korrespondon me një nen të caktuar do të thotë ki bo ti shkelje. Dhe nuk janë opinionet ligjore do të thotë vendime, por e jep një opinion ligjor që në bazë të asaj edhe gjykatat mund të veprojnë, por duke u bazuar në ligje.

Ajo që kam vërejtur edhe në ministrinë përkatëse, ne kemi ligje shumë të mira, por nuk kemi udhëzime administrative që i nxjerrin që është afati gjashtë mujor pas miratimit të ligjit. S'po them vetëm në këtë qeveri, por në të gjitha qeveritë, do të thotë mungojnë udhëzimet administrative, sepse ligji nuk mundet me u lëshua në çështje teknike se atëherë nuk është ligj, apo në strategji. U përmend këtu dallimet mes bordit dhe drejtorit apo kryeshefit ekzekutiv.

Dihet që kryeshefi ekzekutiv është pjesë e bordit, por bordi zhvillon politikën e ndërmarrjes publike dhe nuk përzihet në vendimet ekzekutive, sikur që janë ministritë përkatëse me sekretarët. Dhe duhet ta dalloni edhe pse është anëtarë i bordit mund të ketë ndikim, edhe nëse ju mendoni që duhet me i saktësua rolin e drejtorit ekzekutiv që mos të jetë pjesë e bordit atëherë propozoni një nen dhe jemi okej. Në takimet që i kemi pas me ju në të gjitha shumicën e ndërmarrjeve publike, do të thotë kam vërejtur që ka interferime jo kryeshefi po donë me qenë boss, jo bordi donë me ndikua aty. Janë të caktuara me nene se si, kush e merr rolin në ekzekutiv, kush është që ndërton politika të ndërmarrjes.

Dhe, këtu mendoj që ne duhet të jemi të saktë. Ju kisha lut, këshillë po ju japi nëse i keni përpara propozimet e plotësim-ndryshimit të ligjeve për ndërmarrjet publike atëherë çdo ndërmarrje, çdo zyre ligjore mund të amendamentojë dhe mund të na dërgojë amendamentet pa e miratuar ligjin që ne do t'i marrim nuk do të thotë që politika ua merr për bazë krejt, sepse vendimi politik e merr Kuvendi, ju jepni mendime profesionale që mund ne t'i përzgjedhim, por ju kisha lut që mos të flasim vetëm jo dukuritë negative kështu por saktësoni, neni kaq, kaq mendojmë që duhet të plotësohet me këtë, këtë edhe na kishit ndihmuar edhe neve edhe do të thotë ta keni parasysh që ta ndërtojmë një ligj, ta miratojmë një ligj që është i implementueshëm.

A po doni ligj që do të thotë kontrollon në mënyrë vertikale komplet sistemin a po doni një ligj që kontrollon edhe anën horizontale. Këtu është gërshetim, për shembull u përmendën ndërmarrjet regjionale që aksionarë janë edhe komunat dhe ti nuk mundesh me i tejkalua, sepse një ndërmarrje është bazë e një komune aty dhe komunat participojnë sepse përfshihen 4-5 komuna.

Dhe, këtu mendoj që ne duhet t'i saktësojmë me nene, por sa i përket aseteve ka problem. Listimi i aseteve ka problem i pronave, ka problem dhe ne duhet t'i saktësojmë saktë dhe mendoj që ne këtu si politikë jemi që të krijojmë ligje që janë funksionale, të implementueshme dhe jo të politizuara, sepse sot është kjo qeveri, nesër shkon kjo qeveri vjen tjetra, vjen tjetra shkon tjetra, kemi qenë ne kanë ardhur këta, do të thotë ne asnjëherë nuk guxojmë me bë ligje për veten por për sistemin dhe unë mendoj që atëherë nëse ne e kryejmë këtë punë dhe mos t'i politizojmë gjërat mendoj që sistemi ka për të funksionuar si duhet, pa marrë parasysh nëse duam që me ligj ta sanksionojmë edhe të themi po, bordet do të jenë politike le të bëhet, por bëhet për të gjithë.

Jo aty ta bëjmë mish-mash, gjithmonë ka për shembull në Amerikë ka një sistem presidencial edhe e ndryshojnë ose kudo në ndonjë shtet në regjion, por duhet me u sanksionua me ligj jo me thy ligjin, e përmendët saktë ligji tamam e saktëson që sa i përket kryeshefit ekzekutiv nuk guxon që brenda tri viteve të ketë pozita të larta politike, nuk ke ti çfarëdo udhëzimi ... duhet me ndryshua nenin, as opinion nuk guxon kush me lëshua opinion lidhur me këtë, sepse atëherë merr përgjegjësinë penale.

Jo mendoj që janë këto të sakta dhe ne jemi të disponueshëm që nëse na vijnë, unë po them për vete si deputet i Parlamentit që nëse vjen saktë një nen i propozuar një amendament unë lloj tek partia që duhet me votua në funksion të sistemit, jo në funksion të individit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lekaj!

Atëherë, po vetëm në vazhdim të kësaj çka tha zoti Lekaj.

VALON PREBREZA: I nderuar deputet, ju referuat nen diktatorial, për besë qaty e kemi gjetur prej vitit 2008 është ky ligj, a po? Domethënë e kanë bërë të kaluarën ne po shpresojmë ta ndryshojmë tash, nëse është diktatorial e kanë bërë ata të kaluarit kemi për ta ndryshuar kysmet.

PAL LEKAJ: Së pari, zotëri unë nuk fola se kush e ka bë, kushdo që ta kishte bë, kurdo që ta kishte bërë është nen diktatorial, nëse e kam bërë edhe unë. Por e përmendët edhe ju që duhet me ekzistua. Nëse ju kam dëgjuar mirë e thatë saktë që duhet me ekzistua dhe unë po them që jo nuk duhet sepse nëse ti mendon me i disiplinua zyrtarët e lartë me sanksione kot e ki. Duhet me qenë të vetëdijshëm me krijua një hapësirë që njerëzit të jenë të lirë duke respektuar ligjin në fjalë jo me diktaturë, ligje diktatoriale.

KRYESUESI: Atëherë, nëse s'kemi dikë tjetër që ka dëshirë me dhënë ndonjë koment, sugjerim edhe një herë po e përsëris që po besoj mjaftueshëm është afati data 11 nëntor ta lëmë si datë kur edhe ndonjë koment shtesë mund ta përcillni me shkrim tek adresa e cila ju ka kontaktuar për dëgjimin publik e sigurisht në emër timin, kolegëve, institucionit ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje në këtë dëgjim publik dhe komentet dhe sugjerimet që i dhatë sa i takon ligjit që e kemi në fokus.

Faleminderit dhe mirupafshim në dëgjimet e takimet tjera të radhës.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*